SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A.

PASQYRAT INDIVIDUALE FINANCIARE
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(me raportin e audituesit të pavarur bashkëlidhur)

Përmbajtja

	PAGE
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR	**1**
PASQYRA INDIVIDUALE E TE ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	**2**
PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	**3**
PASQYRA INDIVIDUALE E FLUKSEVE TE PARASE	**4**
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE INDIVIDUALE	**5-32**
SKEDULE SUPLEMENTARE	**i-ii**

pwc

Raport i audituesit të pavarur

Për aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. ("shoqëria") të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013 dhe pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e fluksit të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur më këtë datë si dhe nga një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacion tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar e evidencën e auditimit rreth shumave dhe shënimeve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të njësisë ekonomike. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozicionit financiar të shoqërisë më 31 dhjetor 2013, si dhe të performancës së saj financiare dhe të flukseve të parasë për vitin ushtrimor e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 janë audituar nga një shoqëri tjetër audituese, raporti i të cilës, më datë 30 prill 2013, përmbante një opinion të pamodifikuar për ato pasqyra financiare.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Blvd. Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 10, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F:+355 (4) 2241 639, www.pwc.com/al

Regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 15 korrik 2009 me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm NIPT K91915023A

pwc

Raport i audituesit të pavarur (vazhdim)

Pricewaterhousecoopers Audit sh.p.k

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

26 maj 2014
Tiranë, Shqipëri

Kodra

Kledian Kodra
Auditues ligjor

SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SH.A
Pasqyra individuale e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013
(të gjitha shumat jane në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
AKTIVET			
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	**8**	53,159	39,146
Depozita me afat	**9**	879,412	848,763
Investime në letra me vlerë	**10**	382,710	206,837
Investime në filale	**11**	9,702	9,702
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	**12**	110,983	114,042
Llogaritë e arketueshme të sigurimit e të tjera	**13**	23,080	16,993
Aktive të risigurimit	**15**	7,724	9,283
Tatim fitimi i parapaguar		-	3,808
Inventarë		252	339
Aktive afatgjata materiale	**14**	15,301	16,179
TOTALI I AKTIVEVE		**1,482,323**	**1,265,092**
DETYRIMET			
Detyrimet për humbjen dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	**15**	333,584	263,004
Rezerva për primin e pafituar	**15**	455,816	400,773
Tatimi mbi fitimin për t'u paguar		1,172	
Llogari të pagueshme për risigurimin	**16**	1,757	2,504
Llogari të pagueshme për sigurimin dhe të tjera	**17**	23,290	18,907
TOTALI I DETYRIMEVE		**815,619**	**685,188**
KAPITALI			
Kapitali themeltar	**18**	370,000	370,000
Rezerva e sigurisë	**18**	148,564	117,893
Fitime të pashpërndara		148,140	92,011
TOTALI I KAPITALIT		**666,704**	**579,904**
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		**1,482,323**	**1,265,092**

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë më 14 March 2014 dhe janë firmosur në emër të tyre nga:

Edvin Hoxhaj
Drejtor i Përgjithshëm

Edmira Madani
Drejtore e Financës

Edmira Madani

SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA
SIGAL LIFE
DREJTORIA E PERGJITHSHME
HEAD OFFICE

Shënimet në faqet 5 deri në 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Të ardhura nga primet e shkruara bruto	**19**	579,889	450,603
Prime të shkruara ceduar risiguruesit		(10,327)	(15,172)
Prime të shkruara neto		**569,562**	**435,431**
Ndryshimi neto në rezervën e primeve të pafituara	**15**	(55,043)	22,122
Ndryshimi neto në rezervën e risiguruesit	**15**	(1,560)	(967)
Të ardhura neto nga sigurimi		**512,959**	**456,586**
Të ardhura nga interesi		49,325	37,583
Të ardhura të tjera		393	345
Të ardhura neto		**562,677**	**494,514**
Ndryshimi neto në rezerva të tjera	**15**	(63,546)	(47,565)
Humbjet dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	**15**	(40,288)	(114,020)
Humbjet neto nga sigurim		**(103,834)**	**(161,585)**
Kostot e marrjes në sigurim	**20**	(242,804)	(182,272)
Shpenzime administrative	**21**	(43,082)	(42,100)
Shpenzime te tjera operative	**22**	(8,041)	(7,223)
Fitimi operativ		**164,916**	**101,334**
Fitimi nga kursi i kembimit, neto		(268)	981
Fitimi para tatimit		**164,648**	**102,315**
Tatimi mbi fitimin	**23**	(16,508)	(10,304)
Fitimi i vitit		**148,140**	**92,011**
Të ardhura pëmbledhëse të tjera, neto nga tatimi		-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit		**148,140**	**92,011**

Shënimet në faqet 5 deri në 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SH.A
Pasqyra e individuale e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(të gjitha shumat jane në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali themeltar	Rezerva e sigurisë	Fitime të pashpërndara	Totali
Gjëndja më 1 janar 2012	**370,000**	**84,970**	**98,770**	**553,740**
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit				
Fitimi i vitit	-	-	92,011	92,011
Të ardhura pëmbledhëse të tjera, neto nga tatimi	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit	-	-	92,011	92,011
Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në kapital				
Transferim i fitimit të pashpërndarë në rezervën e sigurisë	-	32,924	(32,924)	-
Dividend i paguar	-	-	(65,846)	(65,846)
Totali i transaksioneve me pronarët	-	32,924	(98,770)	(65,846)
Gjëndja më 31 dhjetor 2012	**370,000**	**117,894**	**92,011**	**579,905**
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit				
Fitimi i vitit	-	-	148,140	148,140
Të ardhura pëmbledhëse te tjera, neto nga tatimi	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit	-	-	148,140	148,140
Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në kapital				
Transferim i fitimit të pashpërndarë në rezervën e sigurisë	-	30,670	(30,670)	-
Dividend i paguar	-	-	(61,341)	(61,341)
Totali i transaksioneve me pronarët	-		**(92,011)**	**(61,341)**
Gjëndja më 31 dhjetor 2013	**370,000**	**148,564**	**148,140**	**666,704**

Shënimet në faqet 5 deri në 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SH.A
Pasqyra individuale e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat jane në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Fluksi i parasë nga vemprimtaritë operative		
Fitimi para tatimit	**164,648**	**102,315**
Rregullime për të barazuar fitimin neto me rrjedhën neto të parasë nga aktivitetet operative:		
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	1,243	1,395
Ndryshimi në rezervën për primin e pafituar	55,043	(22,122)
Ndryshimi në rezervën për risigurimin	1,560	967
Ndryshimi në provigjonin për rezerva të tjera	63,546	47,565
Ndryshimi në detyrimet për humbjen dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	7,034	29,664
Të ardhura nga interesi	(49,325)	(37,583)
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimi e aktiveve afatgjata	-	42
Fluksi i parasë nga veprimtaritë operative përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative	**243,749**	**122,243**
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative:		
Ndryshimi në të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	(6,087)	(10,817)
Ndryshimi në kosto të shtyra të marrjes në sigurim	3,060	16,888
Ndryshimi në inventare	86	(74)
Ndryshimi në llogari të pagueshme për sigurimin dhe të tjera, neto nga të ardhura të shtyra nga interesi.	4,383	2,343
Ndryshimi në llogari të pagueshme për risigurimin	(747)	(2,343)
Tatim fitimi i paguar	(11,527)	(10,470)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti operacional	**232,916**	**117,770**
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerje ndërtesa dhe pajisje	(364)	(176)
Investimi në filiale	-	(9,701)
Rritje/(ulje) në depozitat me afat	(28,192)	29,995
Investime në letra me vlerë (çmimi i paguar)	(168,021)	(112,011)
Interesa të marra	39,015	37,666
Mjete monetare përdorur në veprimtaritë investuese	**(157,562)**	**(54,227)**
Fluksi i parasë nga veprimtaritë financuese		
Dividendi i paguar	(61,341)	(65,847)
Mjete monetare të përdorura në veprimtaritë e financimit	**(61,341)**	**(65,847)**
Rritja/(pakësimi) neto në mjete monetare	**14,013**	**(2,304)**
Mjete monetare në fillim të vitit	**39,146**	**41,450**
Mjete monetare në fund të vitit (shenim 8)	**53,159**	**39,146**

Shënimet në faqet 5 deri në 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA sh.a. (''Shoqëria'') u themelua në shtator 2004 si një shoqëri sigurimi me kapital aksionar dhe u rregjistrua në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 32018, datë 3 shtator 2004. Shoqëria është duke operuar sipas Ligjit Shqiptar nr. 9267 "Për veprimatarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetsimit ne sigurime dhe risigurime" datë 29 korrik 2004. Aktiviteti kryesor i biznesit përfshin dhënien e shërbimit të sigurimit për jetën. Shoqëria filloi aktivitetin në mars 2005 dhe zyrat qëndrore ndodhen në Bulevardin "Zogu I", Tiranë.

Më 31 dhjetor 2013, Shoqëria zotërohet nga SiIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a ("Shoqëria mëmë"), një subjekt rezident në Shqipëri, me shoqeri mëmë Uniqa Versicherunger AG ("Uniqa" ose "Shoqëria mëmë përfundimtare").

2. BAZAT E PERGATITJES

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare për qëllime të veçanta janë përgatitur në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të mbikëqyr nga kuadri ligjor i sigurimeve në Shqipëri nën parimin e kostos historike. Korniza kontabilitetit e aplikuar është bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin 3 të cilat bazohen në vlerësimin SNRF, zbulimin dhe parimet e kontabilitetit me përjashtim të mos-konsolidimit të degës në shtetin e huaj të përshkruar si më poshtë në shënimin 4 (a). Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara janë përcaktuar më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e paraqitura, nëse nuk shprehet ndryshe.

b) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare paraqiten në LEK shqipëtar ("LEK"), i cili është monedhë funksionale dhe e paraqitjes për Shoqërinë dhe është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt nëse nuk shprehet ndryshe.

3. ADOPTIMI I STANDARDEVE TE REJA OSE TE RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme u bene efektive për Kompaninë që prej 1 Janar 2013:

SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" (të lëshuara në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) zëvendëson të gjithë udhëzimet në kontroll dhe konsolidim të SNK 27 "Pasqyrat financiare të ndara dhe të konsoliduara" dhe KIRFN – 12 "Konsolidimi – subjekte me qëllim të veçantë". SNRF 10 ndryshon përkufizimin e kontrollit në mënyrë që të njëjtat kritere aplikohen te të gjitha subjektet për të përcaktuar kontrollin. Ky përkufizim mbështetet nga udhëzime më të gjera aplikimi. Standardi nuk pati efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SNRF 11 « Marrëveshje të përbashkëta » (i lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) zëvendëson SNK 31 "Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta" dhe KIRFN 13 « Subjekte të kontrolluara bashkërisht – Kontribute jo monetare nga sipërmarrësit ». Ndryshimet në përkufizime kanë reduktuar numrin e llojeve të marrëveshjeve të përbashkëta në dy : operacione të përbashkëta dhe sipërmarrje të përbashkëta. Zgjedhja e politikës ekzistuese për konsolidimin proporcional të subjekteve të kontrolluara bashkërisht është eliminuar. Kontabiliteti i kapitalit është i detyruar për pjesëmarrësit në sipërmarrje të përbashkëta. Standardi nuk ka patur impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SNRF 12 « Paraqitja e interesave në subjekte të tjera » (e lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) aplikohet në subjekte që kanë interes në një filial, një sipërmarrje të përbashkët, me pjesëmarrje ose një entitet me strukturë të pakonsoliduar. Kjo zëvendëson kërkesat për paraqitje që më përpara gjendeshin te SNK 28 « Investime në Pjesëmarrje ». SNRF 12 u kërkon subjekteve të paraqesin informacionin që ndihmon lexuesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë natyrën, riskun dhe efektet financiare të lidhura me interesat e subjektit në filiale, në subjekte me pjesëmarrje, sipërmarrje të përbashkëta dhe subjekte me strukturë të pakonsoliduar.

3. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (VAZHDIM)

Në mënyrë që të arrihen këto objektiva, standardi i ri kërkon paraqitjen në disa fusha, duke përfshirë dhe gjykimet dhe supozimet e bëra nëse një subjekt kontrollon, kontrollon bashkërisht, ose influencon në mënyrë të konsiderueshme interesat e tij në subjekte të tjera, shpalosjen e mëtejshme të pjesës së interesave të pakontrolluara në aktivitetet e grupit dhe flukseve të mjeteve monetare, të përmbledhura në informacionin financiar të filialeve me interesa të pakontrolluara materiale, paraqitje të detajuara të interesave në entitete me strukturë të pakonsoliduar. Standardi nuk ka patur impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë***SNRF 13 "Matja e vlerës së drejtë" (botuar në maj 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013)*** përmirësoi qëndrueshmërinë dhe të reduktoi kompleksitetin duke siguruar një përkufizim të rishikuar të vlerës së drejtë, dhe një burim të vetëm të matjes me vlerën e drejtë dhe kërkesat për deklarim për përdorim në të gjithë SNRF-të. Standarti nuk ka patur impakt material në pasqyrat financiare individuale të shoqërisë.

SNK 27 « Pasqyra të Ndara Financiare » (të ndryshuara në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) u ndryshua dhe objektivi i saj tashmë është të përcaktojë kërkesat kontabël dhe të paraqitjes për investimet në filiale. Udhëzimi në kontroll dhe pasqyra financiare të konsoliduara u zëvendësua nga SNRF 10 « Pasqyra Financiare të Konsoliduara ». Standardi i ndryshuar nuk ka patur impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SNK 28 « Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta » (e lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013). Ndryshimi i SNK 28 rezultoi nga projekti i Bordit për sipërmarrjet e përbashkëta. Gjatë diskutimit të projektit, Bordi vendosi të përfshijë kontabilitetin për sipërmarrjet e përbashkëta duke përdorur metodën e kapitalit të SNK 28 sepse kjo metodë aplikohet si për sipërmarrjet e përbashkëta ashtu dhe atyre me pjesëmarrje. Përveç këtij rasti, udhëzimet e tjera mbeten të pandryshuara. Standardi i ndryshuar nuk ka impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SNK 1 i ndryshuar « Prezantimi i Pasqyrave Financiare » (të ndryshuara në Qershor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) ndryshoi paraqitjen e artikujve të prezantuar te të ardhura të tjera të përmbledhura. Ndryshimet kërkojnë që subjektet të ndajnë artikujt e prezantuar në të ardhura të tjera të përmbledhura në dy grupe, bazuar në faktin nëse ato do të riklasifikohen apo jo në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të ardhmen. Titulli i sugjeruar i përdorur nga SNK 1 ka ndryshuar në « pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera të përmbledhura ». Standardi i ndryshuar rezultoi në ndryshimin e prezantimit të pasqyrave financiare, po nuk pati impakt në matjen e transaksioneve apo balanca.

SNK 19 i ndryshuar « Përfitimet e Punonjësve » (e lëshuar në Qershor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) rezulton në ndryshime të rëndësishme në njohjen dhe matjen e shpenzimeve për pension dhe për largimin nga puna, si dhe për paraqitjen e të gjitha përfitimeve të punonjësve. Standarti kërkon njohjen e të gjitha ndryshimeve në pasivin (aktivin) neto të përcaktuar të përfitimit, në momentin që ato ndodhin si më poshtë : (i) Kosto e shërbimit dhe interesi neto në të ardhura shpenzime dhe (ii) Rimatjet e të ardhurave të tjera të përmbledhura. Grupi raporton sasinë e akumuluar të këtyre rimatjeve në fitimet e pashpërndara në kapital.Standardi i ndryshuar nuk ka impakt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.
« Paraqitja – Netimi i Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare" – Ndryshimet e SNRF 7 (e lëshuar në Qershor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013). Ndryshimet kërkojnë paraqitjen në mënyrë të tille që i mundëson përdoruesit e pasqyrave financiare të Shoqërisë të vlerësojnë efektin ose efektin potencial të netimit të rregullimeve, duke përfshirë të drejtat e netimit. Standardi i ndryshuar nuk ka impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë. **Përmirësime të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (e lëshuar në Maj 2012 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013).**

3. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (VAZHDIM)

Përmirësimet konsistojnë në ndryshimet e pesë standardeve. SNFR 1 ndryshoi në (i) qartësimin se subjekti që përmbledh përgatitjen e Pasqyrave Financiare SNFR mund të ketë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme SNFR 1 ose të gjitha SNFR retrospektivisht pasi nuk kishte ndaluar kurrë së aplikuari ato, dhe (ii) për të shtuar një përjashtim nga zbatimi i SNK 23 "Kostot e huamarrjes", në mënyrë retrospektive nga adoptuesit për herë të parë.
SNK 1 është ndryshuar për të qartësuar se shënimet shpjeguese nuk janë të nevojshme për të mbështetur bilancin e tretë bilancin e paraqitur në fillim të periudhës se mëparshme kur ai jepet pasi ndikohet materialisht nga një riparaqitje retrospektive, ndryshime ne politikat kontabël dhe riklasifikime për qëllime prezantimi, ndërkohë që shënimet shpjeguese do te kërkohen kur një subjekt në mënyrë vullnetare vendos te japë pasqyra krahasuese shtesë. SNK 16 u ndryshua për të sqaruar që pajisjet që janë përdorur për shërbim për më shumë se një periudhë klasifikohen si aktive fikse, jo si inventar. SNK 32 u ndryshua për të sqaruar se pasojat e caktuara tatimore të shpërndarjeve tek pronarët duhet të kontabilizohen në pasqyrën e të ardhurave si kërkohej gjithmonë nga SNK 12. SNK 34 u ndryshua për të sjellë kërkesat e saj në përputhje me SNRF 8. SNK 34 tani kërkon dhënien e një sasie të totalit të aktiveve dhe detyrimeve për një segment operativ vetëm nëse informacioni përkatës i jepet rregullisht vendimmarrësit operacional dhe ka pasur një ndryshim material në ato masa që nga pasqyrat financiare vjetore të fundit . Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

"Ndryshimet e Udhëzimeve të Tranzicionit në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12" (lëshuar në qershor të vitit 2012 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2013). Ndryshimet qartësojnë udhëzimet tranzitore në SNRF 10 " Pasqyra të Konsoliduara Financiare ". Subjektet që adoptojnë SNRF 10 duhet të vlerësojë kontrollin në ditën e parë të periudhës vjetore në të cilën SNRF 10 është e miratuar , dhe në qoftë se konkluzioni i konsolidimit nën SNRF 10 ndryshon nga SNK 27 dhe KIRFN 12, periudha krahasuese e mëparshme (pra, viti 2012) është riparaqitur , përveç nëse e pazbatueshme. Ndryshimet gjithashtusigurojnë lehtësim tranzicioni shtesë në SNRF 10 , SNRF 11 " Marrëveshjet e përbashkëta " dhe SNRF 12 "Shpalosja e interesave në subjekte të tjera ", duke kufizuar kërkesën për të siguruar informacion të përshtatur krahasues vetëm për periudhën që paraprin menjëherë periudhën krahasuese. Më tej, ndryshimet heqin kërkesën për të paraqitur informacion krahasues për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me subjektet e pakonsoliduara të strukturuara për periudha para se SNRF 12 të zbatohej për herë të parë . Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të shoqërisë, përveç zbatimit të lehtësim nga zbulimi i disa informacioneve krahasuese në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Standarde dhe interpretime të tjera të rishikuara: KIRFN (Komiteti i Interpretimit të Raportimit Financiar Ndërkombëtar) 20 "Kostot e pastrimit të minierave sipërfaqësore në fazën e prodhimi", merr në konsideratë kur dhe si të llogariten përfitimet që rrjedhin nga aktiviteti i pastrimit të sipërfaqes në industrinë e minierave. Interpretimi nuk kishte ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të të konsoliduara të Grupit. Ndryshimet në SNRF 1 "Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për herë të parë – Kreditë qeveritare", të cilat janë lëshuar në Mars 2012 dhe të bëra efektive për periudha njëvjeçare duke filluar nga 1 Janar 2013, ju vijnë në ndihmë përdoruesve për herë të parë të SNRF-ve nga zbatimi i plotë retrospektiv i kërkesave të kontabilitetit për kreditë e marra nga qeveria me norma më të ulëta se tregu. Ndryshimi nuk është i vlefshëm për Shoqërinë.

Janë hartuar disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014 ose më vonë, dhe të cilat nuk janë përdorur nga Shoqëria më përpara.

3. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (VAZHDIM)

SNRF 9 "Instrumentet Financiare: Klasifikimi dhe vlerësimi". Veçoritë kryesore të standardit të hartuar në Nëntor 2009 dhe të ndryshuar në Tetor 2010, Dhjetor 2011 dhe Nëntor 2013 janë:

- Instrumentet financiare kërkohet të klasifikohen në dy kategori: ato që vlerësohen me vlerën e drejtë dhe ato që maten me koston e amortizuar. Vendimi për këtë merret në fazën fillestare të njohjes së instrumentit financiar. Klasifikimi varet nga modeli i biznesit të njësisë për të menaxhuar këto instrumente dhe karakteristikat e flukseve të mjeteve monetare të kontraktuara të instrumentit.
- Një instrument mbahet me kosto të amortizuar vetëm nëse është instrument borxhi, si dhe (i) objektivi i modelit të biznesit të subjektit është ta mbajë aktivin deri në mbledhjen e flukseve të mjeteve monetare të kontraktuara dhe (ii) flukset e mjeteve monetare të kontraktuara të aktivit përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (që do të thotë se aktivi ka vetëm "karakteristika bazë të kredisë"). Të gjitha instrumentet e tjera të borxhit mbahen me vlerën e drejtë duke krijuar fitim ose humbje.
- Të gjithë instrumentet e kapitalit mbahen me vlerë të drejtë. Instrumentet e kapitalit të mbajtura për shitje do të mbahen me vlerë të drejtë me fitim apo humbje. Për të gjithë investimet e tjera në instrumente kapitali, në fazën e njohjes fillestare bëhet një zgjedhje e pandryshuar për të njohur fitimet apo humbjet e realizuara ose të parealizuara në të ardhurat e tjera përmbledhëse në vend të fitimit ose humbjes. Nuk duhet bërë riciklim i fitimeve nga vlera e drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kjo zgjedhje mund të bëhet në bazë të instrumentit. Dividendët paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për sa kohë që ata përfaqësojnë një kthim nga investimi.
- Shumë nga kërkesat e SNK 39 për klasifikimin dhe vlerësimin e detyrimeve financiare kaluan të pandryshuara në SNRF 9. Ndryshimi i vetëm konsiston në kërkesën që subjekti të paraqesë efektet e ndryshimeve në riskun e kredisë së detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të ardhura të tjera përmbledhëse.
- Kërkesat e kontabilitetit të mbrojtjes u ndryshuan me qëllim që ta lidhin kontabilitetin më shumë me menaxhimin e riskut. Standardi ju ofron subjekteve një mundësi për zgjedhjen e politikës kontabël ndërmjet kërkesave të zbatimit të kontabilitetit të mbrojtjes në SNRF 9 dhe vazhdimit të aplikimit të SNK 39 për të gjitha mbrojtjet sepse standardi aktual nuk trajton kontabilitetin për mbulimet makro.

Ndryshimet e bëra në SNRF 9 në Nëntor 2013 hoqën datën efektive të detyrueshme, duke bërë zbatimin e standardit vullnetarisht. Shoqëria nuk synon të përshatë versionin aktual të SNRF 9.

"Netimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare" – Ndryshimet e SNK 32 (lëshuar në Dhjetor 2011 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014 ose më pas). Ndryshimet shtuan udhëzime të aplikimit të SNK 32 për të trajtuar mospërputhjet e identifikuara gjatë aplikimit të kritereve të netimit. Kjo përfshin qartësimin e kuptimit të "aktualisht ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për netim" dhe që disa sisteme pagesash bruto mund të konsiderohen ekuivalente me pagesa neto. Shoqëria po shqyrton implikimet e ndryshimeve dhe ndikimin në Shoqëri.

Ndryshimet e SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27 – Subjektet investuese" (lëshuar në 31 Tetor 2012 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014). Ndryshimi paraqiti një përkufizim të një subjekti investues si një subjekt që (i) siguron fonde nga investitorë me qëllim shpërblimin e tyre me shërbime të menaxhimit të investimeve, (ii) angazhohet tek investitorët që qëllimi i biznesit është investimi i fondeve vetëm për rritjen e vlerës së kapitalit ose të ardhurat nga investimi dhe (iii) mat dhe vlerëson investimet e saj në bazë të vlerës së drejtë. Një subjekt Investues kërkohet të përllogarisë për filialet vlerën e drejtë me fitim apo humbje dhe të konsolidojë vetëm ato filiale që ofrojnë shërbime të lidhura me aktivitetet investuese të njësisë. SNRF 12 u ndryshua për të futur mënyra të reja paraqitjeje, duke përfshirë gjykime të rëndësishme në përcaktimin nëse një njësi investuese dhe nëse informacioni financiar ose jo për një filial të pa konsoliduar është një synim apo i është ofruar filialit. Shoqëria nuk pret që ndryshimi të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

3. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (VAZHDIM)

KIRFN 21 – "Mbledhja e taksave (**(lëshuar në 20 Maj 2013 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014).** Interpretimi qartëson kontabilizimin e një detyrimi për të paguar taksa/tatime që nuk janë tatim fitim. Ngjarja që shkakton një detyrim është ajo ngjarje e identifikuar nga legjislacioni që shoqëron detyrimin me një pagesë takse. Fakti që subjekti është ekonomikisht i detyruar të vazhdojë të operojë në një periudhë të ardhshme, ose përgatit pasqyrat financiare me supozimin e vazhdimësisë, nuk krijon një detyrim. Të njëjtat parime njohjeje aplikohen në pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore. Zbatimi i interpretimit të detyrimeve që rrjedhin nga skemat e tregtimit të emetimeve është fakultativ. Shoqëria po vlerëson aktualisht ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat financiare.

Ndryshimet e SNRF 36 – "Paraqitjet e vlerës së rikuperueshme nga aktivet jo-financiare" **lëshuar në Maj 2013 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014; zbatimi më përpara lejohet vetëm nëse SNRF 13 aplikohet për të njëjtën periudhe kontabël dhe krahasuese).** Ndryshimet heqin kërkesat për paraqitjen e vlerës së rikuperueshme kur një Njësi Gjeneruese e Mjeteve Monetare përmban emër të mirë ose aktive jomateriale me jetë të papërcaktuar, por që nuk janë zhvlerësuar. Shoqëria po vlerëson aktualisht ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat financiare.

Ndryshimet e SNRF 39 – "Ndryshimet e derivativeve dhe vazhdimësia e kontabilitetit të mbrojtjes" (lëshuar në Qershor 2013 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014). Ndryshimet do të lejojnë vazhdimin e kontabilitetit të mbrojtjes në një situatë ku një derivativ, i cili është trajtuar si një instrument mbrojtës, është ndryshuar (p.sh. palët kanë vendosur të zëvendësojnë palën tjetër) me qëllim që të ndikojë kompensimin me një palë tjetër qendrore si rezultat i ligjeve ose rregulloreve, nëse përmbushen disa kushte specifike. Shoqëria po vlerëson aktualisht ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat financiare.

Ndryshimet e SNK 19 – "Plani i përcaktuar i përfitimeve: kontributet e punonjësve" lëshuar në Nëntor 2013 dhe të bëra efektive për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1

Korrik 2014). Ndryshimi i lejon subjektet të njohin kontributet e punonjësve si një reduktim i kostove të shërbimit në periudhën në të cilën shërbimi i punonjësit është dhënë, në vend që të atribuohet kontributi në periudhën e shërbimit, nëse shuma e kontributeve të punonjësve është e pavarur nga numri i viteve të shërbimit. Shoqëria nuk pret të ketë ndonjë impakt material nga ndryshimet në pasqyrat financiare të të vecanta.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL TË RËNDËSISHME

a) Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë ato të investuarit , duke përfshirë këtu njësitë ekonomike të strukturuara , që Shoqëria kontrollon sepse ajo i) ka fuqi për të drejtuar aktivitetet përkatëse të njësisë ku është investuar që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme kthimin e tyre , (ii) ka ekspozim , ose të drejta , me kthime të ndryshme nga përfshirja e saj me të investuarit , dhe (iii) ka aftësinë për të përdorur fuqinë e saj mbi të investuarit për të ndikuar në shumën e kthimit të investitorit. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave substanciale duke përfshirë të drejtat substanciale votuese potenciale , konsiderohen kur vlerësohet nëse Shoqëria ka fuqi mbi një subjekt tjetër. Që një e drejtë të jetë e pavarur , mbajtësi duhet të ketë aftësinë praktike për ta ushtruar atë të drejtë kur vendimet për drejtimin e aktiviteteve përkatëse të të investuarit duhet të bëhen. Shoqëria mund të ketë pushtet mbi një të investuar edhe kur ajo mban më pak se shumica e fuqisë votuese në një të investuar . Në një rast të tillë , shoqëria vlerëson madhësinë e saj të të drejtave të votimit dhe shpërndarjen e zotërimeve të tjera të votave për të përcaktuar fuqinë de- facto mbi të investuarit. Të drejta mbrojtëse të investitorëve të tjerë , të tilla si ato që kanë të bëjnë me ndryshimet themelore të aktiviteteve të investuarit ose që zbatohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme nuk e pengojnë kontrollin e Shoqërisë mbi një të investuar . Filialet janë konsoliduar në pasqyrat e konsoliduara të shoqërisë financiare nga data e transferimit të kontrollit nga filiali te shoqëria (data e blerjes) dhe hiqen nga konsolidimi në datën kur përfundon kontrolli.

Metoda e blerjes në kontabilitet është përdorur për të llogaritur blerjen e filialeve. Aktivet e identifikueshme të blera dhe detyrimet ose detyrimet me kusht të konstatuara në një kombinim biznesi janë matur me vlerën e tyre të drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga shtrirja e çdo interesi jo-kontrollues.

Një shoqëri mëmë nuk është e nevojshme të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, nëse edhe vetë shoqëria mëmë është filial i një shoqërie tjetër dhe nëse shoqëria mëmë përfundimtare ose një shoqëri mëmë e ndërmjetme përgatit pasqyra financiare të konsoliduara të cilat janë të publikueshme dhe në përputhje me SNRF. Shoqëria nuk e konsolidon aktivitetin e filialit të saj dhe përgatit pasqyra financiare të veçanta, por aktivitetet e të dyja shoqërive konsolidohen në pasqyrat financiare të Shoqërisë mëmë përfundimatare-Uniqa, një entitet rezident në Austri, e cila përgatit pasqyra financiare të konsoliduara të cilat janë të disponueshmë për publikun e gjerë dhe që janë në përputhje me SNRF. Investimi në filiale është paraqitur me kosto në këto pasqyra financiare të veçanta .

b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare të regjistruara në monedha të huaja ne daten e raportimit, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e kembimit të datës së raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të regjistruara në monedhë të huaj që matën me kosto të amortizuar, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e kembimit në datën kur kryhet transaksioni. Diferencat që vijnë nga këmbimet valutore njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

c) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Kontrata nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguruese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin, janë klasifikuar si kontrata sigurimi. Rreziku i sigurimit është një rrezik ndryshe nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të mundëshme të ardhëshme në një ose në disa norma interesi specifike, cmimet e letrave me vlerë, kursi i këmbimit, indekset e cmimeve ose të normave, normat e kreditimit apo indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiarë kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL TË RËNDËSISHME(VAZHDIM)

d) Njohja dhe matja e kontratave

Primet për sigurimin e jetës

Primet nga sigurimi i jetës përfshijnë primet nga kontratat e nënshkruara gjatë vitit, pavarësisht nëse rreziku shtrihet pjeserisht ose plotësisht në periudhat e mëvonshme kontabël. Primet përfshijnë komisionet e pagueshme ndaj ndërmjetësve dhe paraqiten neto nga taksat e pagueshme mbi to. Pjesa e fituar e primeve njihet si e ardhur. Primet fitohen që nga momenti i lidhjes me rrezikun përgjatë gjithë periudhës së mbuluar në basë të modelit të rrezikut të marë përsipër. Primet për risigurim njihen si shpenzime në përputhje me modelin e shërbimit të risigurimit të përfituar.

Rezerva për primet e pafituara

Rezerva për Jetën e Debitorit është përllogaritur nëpërmjet metodave aktuariale duke marrë në konsideratë vlerën e pamaturuar të policës së sigurimit të rregulluar me koefiçentin e rrezikut të vdekshmërisë. Shoqëria ka përdorur metodën pro-rata (metodën 1/365) për të përcaktuar primin e pafituar për sigurimin shëndetësor. Primi i pafituar është llogaritur neto nga shpenzimet e marrjes në sigurim për jetën, jetën e debitorit dhe shëndetin. Primi i pafituar për Pagesë e Siguracionit për Mbrojtjen(PSM)është paraqitur bruto. Efekti i kostos së marrjes në sigurim është vlerësuar bazuar në normën e kostos së marrjes në sigurim ndaj primit të shkruar bruto.

Dëmet

Përfitimet e ndodhura për sigurimin e jetës gjatë aktivitetit të përgjithshëm përbëhen nga dëmet e paguara gjatë vitit financiar bashkë me ndryshimin në rezervën për dëmet pezull. Rikuperimet në avancë nga risigurimi paraqiten më vete si aktive. Rikuperimet nga risigurimi dhe rikuperime të tjera vlerësohen në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve pezull.

Rezervat për dëmet

Rezerva përfaqëson vlerësimin e kostos përfundimtare të shlyerjes së të gjitha dëmeve, duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte të shlyerjes së dëmit, të cilat lindin nga ngjarje që kanë ndodhur deri në datën e raportimit, dukë përfshirë një llogaritje të kostos së dëmeve të ndodhura por të pa raportuara (IBNR) në atë datë. Rezerva për dëmet pezull krijohet rast pas rasti në shumën e pagesës së pritshme. Rezervat për dëmet e ndodhura por të pa raportuara krijohet duke përdorur metodën e trekëndshave.

Rezerva të tjera(matematike)

Rezerva të tjera është përllogaritur mbi bazë police duke përdorur formula aktuariale standarte të bazuara në rezervën neto. Vlerësimet mbi mortalitetin dhe normën e interesit të përdorura për rezervën janë në përputhje me vlerësimet e çmimit ku 85% e fitimit shtesë kthehet në vjetorin e policës.

Risigurimi

Kontratat që transferojnë një pjesë kryesore të rrezikut të sigurimit janë kontabilizuar si risigurime. Shumat e rikuperueshme nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit si dhe dëmet e lidhura. Aktivet e risigurimit përfshijnë balancat për t'u arkëtuar nga Shoqëritë e risigurimit për detyrimet nga sigurimet e ceduara. Shumat e rikuperueshme nga risiguruesit llogariten në të njëjtën mënyrë si janë llogaritur rezervat e dëmeve pezull, ose përbëjnë pjesën e papaguar nga risiguruesi të dëmeve të paguara nga Shoqëria që lidhen me policën e risiguruar.Shoqëria cedon primet e sigurimit dhe rrezikun për të limituar humbjet e mundshme lindur nga ekspozimi në rreziqe të konsiderueshme nga sigurimi i jetës. Risigurimi nuk e çliron siguruesin fillestar nga detyrimet e tij. Primet e ceduara paraqiten në pasyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në shumën e ngarkuar gjatë vitit. Shumat e rimbursuara janë paraqitur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe në pasqyrën e pozicionit financiar në bazë bruto. Portofoli i produkteve është mbuluar nga një kontratë risigurimi e detyrueshme që mbulon pjesën mbi shumën maksimale të rrezikut për çdo jetë. Çdo përfitim shtesë, ndahet midis shumës së mbajtur dhe tejkalimit në të njëjtin proporcion si shuma e siguruar e jetës. Pjesa e rezervës së risigurimit përcaktohet rast pas rasti në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL TË RËNDËSISHME(VAZHDIM)

Test i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në çdo datë raportimi Shoqëria kryen testime për t'u siguruar për mjaftueshmërinë e rezervës së dëmeve. Testimet kryesore të kryera janë "Analiza e Raportit të Dëmeve" dhe "Analiza e Zhvillimit të Provigjoneve të Dëmeve". Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit individualisht në produktet kryesore të biznesit (sigurim jete dhe jetë e kombinuar). Llogaritja kryhet vetëm mbi dëmet, por edhe mbi dëme që përfshijnë koston e marrjes në sigurim dhe kosto të tjera të jashtme të lidhura me dëmin. Në kryerjen e kësaj analize Shoqëria merr në konsideratë parashikimet aktuale të flukseve monetare dalëse. Shoqëria nuk i skonton këto flukse monetare të parashikuara sepse shumica e dëmeve priten të paguhen brenda vitit.

Shoqëria gjithashtu kryen një analizë vjetore të zhvillimit të provigjonimit të dëmeve për vlerësimin e metodologjisë së provigjonimit. Nëse një mospërputhje identifikohet, ajo i ngarkohet menjëherë fitimit ose humbjes duke krijuar një rezervë rreziku të paskaduar nga humbjet e ardhura nga Testi i Mjaftueshmërisë së Detyrimeve.

e) Instrumentet financiare

(i) Njohja

Shoqëria fillimisht njeh kreditë dhe depozitat në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet financiare njihen në datën e transaksionit sipas së cilit Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

(ii) Klasifikimi

Shiko politikat kontabël 3(f),(g),(h),(i),(j) dhe (k).

(iii) Çregjistrimi

Shoqëria c'regjistron një aktiv financiar nëse humbet kontrollin mbi flukset e ardhshme të parasë ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione ku i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivi financiar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv ose detyrim i vecantë.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhen, anullohen ose maturohen.

(iv) Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka qëllim të arkëtoje ose të mbylli aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi financiar është vlera me të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv duke marrë parasysh ndonjë diferencë midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

(vi) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumentave financiare në tregjet aktive. Për të gjitha instrumentat financiare të tjerë vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të tilla si vlera reale neto, metoda e aktualizimit të flukseve, krahasimi me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat çmimet përcaktohen në tregje aktive, si dhe modele të tjera vlerësimi.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIMI)

e) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare Shoqëria vlerëson nëse ka evidenca objektive për rënien në vlerë të aktiveve financiare. Aktivet financiare pësojnë rënie në vlerë kur evidenca objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit te mëparshëm të aktivit, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e mjeteve monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme.

Shoqëria merr në konsideratë evidenca për rënien në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup të aktiveve. Të gjitha aktivet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë. Të gjitha aktivet individalisht të rëndësishme të cilat nuk gjënden të rëna në vlerë nga testimi specifik, vlerësohen së bashku për rënie në vlerë e cila mund të ketë ndodhur, por që ende nuk është identifikuar. Të gjitha aktivet që nuk konsiderohet të jenë individualisht të rëndësishëm grupohen dhe vlerësohen së bashku me aktive me karakteristika të ngjashme (të mbajtura me kosto të amortizuar) për rënie në vlerë.

Si evidence objektive për rënie në vlerë të mundshme të aktiveve në pasqyrat financiare mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Shoqëria me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar, tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si, ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që ndikojnë në përkeqësim të grupit të aktiveve.

f) Mjetet monetare dhe ekuivalente me to

Mjetët monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

g) Depozitat me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjeteve monetare, ato me maturitet midis tre dhe dymbëdhjetë muaj klasifikohen si investime në depozita me afat. Interesi llogaritet në bazë rrjedhëse dhe interesi i arkëtueshëm pasqyrohet në llogaritë e tjera të arkëtueshme.

h) Investimi në letra me vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Shoqëria ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim dhe si rrjedhim maten me kosto të amortizuar, minus provigjionin për rënien në vlerë. Kosto e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje.

i) Llogari të arkëtueshme të sigurimit e të tjera

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera, paraqiten në koston e tyre minus provigjonet për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta.

j) Inventari

Inventarët regjistrohen me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme dhe janë të përfshira në aktive të tjera. Kostoja e inventarit përcaktohet në bazë të mesatares së ponderuar dhe përfshin politikat e para-shtypura dhe konsumit. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus koston e vlerësuar të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

k) Llogari të pagueshme nga sigurimi dhe detyrime të tjera

Llogaritë e pagueshme nga sigurimi dhe të tjera mbahen njhen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e transaksioneve të lidhura drejtpërdrejt me të.Këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIMI)

l) Ndërtesa dhe paisje

(i) Njohja dhe matja

Zërat e ndërtesës dhe paisjeve maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat lidhen direkt me koston e blerjes së aktiveve. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë si edhe kostot çmontimit e rikthimit të vendit në të cilin ato do të vendosen, në gjendjen e tij fillestare. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë integrale e funksionimit të paisjes kapitalizohet si pjesë e paisjes. Kur pjesë të një zëri të ndërtesës ose paisjeve kanë jetgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si zëra të ndarë (përbërësit kryesor) të ndërtesës dhe paisjeve.

(ii) Kostot e mëvonshme

Kostoja e zëvendesimit të një elementi të ndërtesa dhe paisje, i shtohet vlerës së mbartur të këtij elementi nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhen më këtë element do të shkojnë për Shoqërinë, dhe kostoja e tij mund te matet me besueshmëri. Kostot e mirëmbajtjes ditore te ndërtesave dhe paisjeve njihen ne pasqyren e te ardhurave ne momentin kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metoden e llogaritjes mbi vlerën e mbetur. Aktivet e marra me qira amortizohen për periudhën më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet. Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe ate krahasuese është si më poshtë:

Ndërtesat	5%
Pajisje zyre	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Mjete transporti	20%

m) Aktive jo-materiale

Aktivet jo-materiale të shoqërisë të ndryshme nga emri i mirë kanë jetë të dobishme të caktuar dhe kryesisht përfshijnë programe kompjuterike të kapitalizuara, patenta, marka tregtare dhe liçencat. Liçencat e programeve kompjuterike, patentat dhe markat tregtare kapitalizohen në bazë të shpenzimeve të bëra për t'i marrë dhe vënë në përdorim.

Kostot e zhvillimit që lidhen direkt me software të identifikueshme dhe unike që kontrollohen nga Shoqëria regjistrohen si aktive jo-materiale nëse rrjedhja e përfitimeve ekonomike në rritje i tejkalon kostot. Kostot e kapitalizuara përfshijnë shpenzimet e stafit të zhvillimit të programeve kompjuterike dhe një pjesë përkatëse të shpenzimeve të përgjithshme përkatëse. Të gjitha kostot e tjera që lidhen me programe kompjuterike, p.sh. mirëmbajtja e saj, janë shpenzuar kur ndodhin. Aktivet jo-materiale amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së tyre të dobishme prej 7 vjet.

n) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, vlera kontabël vlerësohet. Një humbje nga rënia në vlerë njihet kurdoherë që vlera e mbartur e një aktivi ose njësia e tij e gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon shumën e tij të rikuperueshme. Njësi gjeneruese e mjeteve monetare është njësia më e vogël e identifikueshme e grupimit të aktiveve që gjeneron flukse monetare të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e një mjeti ose një njësie gjeneruese është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës reale pasi janë zbritur kostot e shitjes. Në përllogaritjen e vlerës në përdorim, flukset e pritshme për t'u arkëtuar aktualizohen duke përdorur një normë të rregulluar për efektin e taksës e cila reflekton vlerësimet e tregut për vlerën në kohë të parasë si edhe risqet specifike që lidhen me aktivin. Humbja nga zhvleresimi rishikohet në çdo datë raportimi nëse ka tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvleresimi rimerret nëse ka patur nje ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën, me të cilën vlera e mbartur e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbetur te tij e cila do ishte percaktuar si vlera neto pas amortizimit nese nuk do ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIMI)

o) Kapitali aksioner

Kapitali aksioner njihet në vlerë nominale.

p) Njohja e të ardhurave

Politikat kontabël për njohjen e të ardhurave nga kontratat e sigurimit janë paraqitur në notën 3(d).
Të ardhurat nga interesi për aktivet financiare është njohur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

q) Shpenzimet e marrjes në sigurim

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, të tilla si, komisionet e blerjes dhe kostot e krijimit të dokumentit të sigurimit dhe pjesën e shpenzimeve administrative që lidhen me proçesin e propozimit dhe emetimit të policave.

r) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në momentin që ato ndodhin .

s) Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që i sigurojnë punonjësve përfitime pensioni kur këta të fundit dalin në pension. Autoritetet respektive të sigurimeve shoqërore të çdo juridiksioni legal kanë përgjegjësinë të sigurojnë kufirin e minimumit ligjor të pagesës për pension nën skemën e planit të pensionit me kontribute të përcaktuara. Kontributet e Shoqërisë për planin e përfitimit të pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse në momentin që ato lindin.

t) Qeratë operative

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse në bazë lineare për të gjithë periudhën e qirasë.

u) Tatimi Fitimi

Tatimi mbi fitimin për vitin pëfshin tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur në mënyrë direkte në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat e tatimit në datën e raportimit dhe ndonjë rregullim të tatimit në lidhje me tatimin e pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet për sa i përket diferencave të përkohëshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllim raportimi financiar dhe vlerave të përdoruar për qëllim tatimor. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen mbrapsht, bazuar në ligjet që jane në fuqi ose pranë miratimit në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit aktivi të mund të përdoret. Tatimi i shtyrë rishikohet çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën sa nuk ka më mundësi që përfitimi nga tatimi mund të realizohet. Ne përcaktimin e vlerës së tatim fitimit aktual dhe të shtyrë Shqëria merr parasysh impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse taksa dhe interesa shtesë mund të jenë të pagueshme. Shoqëria beson se përllogaritjet për detyrime tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet, bazuar në vlerësimin e shumë faktoreve, përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe eksperiencën e mëparshme. Kjo përllogaritje mbështetet në vlerësime e supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacione të reja që mund të dalin në dritë, mund të ndikojnë që Shoqëria të ndryshoje gjykimet në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime te tilla ne detyrimet tatimore do te kene impakt mbi tatim fitimin aktual në periudhën që ky ndryshim do bëhet.

5. MENAXHIMI I RREZIKUT TE SIGURIMIT

a) Objektivat e menaxhimit të rreziqeve dhe politikat për të ulur rrezikun e sigurimit

Rreziku nga kontratat e sigurimit është mundësia që ngjarja e siguruar ndodh dhe prej pasigurisë rreth shumës së dëmit. Për vetë natyrën e kontratave të sigurimit, ky rrezik është i rastësishëm dhe i paparashikueshëm. Shoqëria e pranon rrezikun nga sigurimi nëpërmjet kontratave të sigurimit dhe disa kontratave të investimeve ku ajo mbart rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë të lidhura direkt me humbjen. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve nën këto kontrata.

Risigurimi blihet nga Shoqëria për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të patur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risigurues të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrëveshjeve për humbjen.

Kapitali rregullator menaxhohet (por jo vetëm) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar. Për një portofol të kontratave të sigurimit ku teoria e propabilitetit është aplikuar për vendosjen e çmimit dhe provigjonimin, rreziku kryesor që Shoqëria ka nga kontratat e saj të sigurimit është se dëmet aktuale dhe pagesat e përfituesit janë më të mëdha se vlera e mbartur e detyrimeve të sigurimit. Kjo mund të lindë sepse frekuenca ose ashpërsia e dëmit dhe përfitimit janë më të mëdha se llogaritja. Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore. Eksperienca tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

b) Strategjia e marrjes në sigurim

Shoqëria ka zhvilluar strategjinë e saj të marrjes në sigurim duke diversifikuar llojin e rreziqeve të cilat ajo pranon dhe brënda secilës kategori të arrijë një popullatë rreziku relativisht të madhe për të ulur luhatjet e rezultateve të pritshme.

c) Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit

Përgjithesisht, të gjitha produktet e Shoqërisë mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë, ne disa raste mbulimi kufizohet ne mbulim te pjesshem, te humbjeve si pasoje e aksidenteve. Produktet e tjera pervec Jetës me Kursim kanë karakteristika të njëjta të produkteve me afat të shkurtër dhe janë të rinovueshme çdo vit me opsionin e ndryshimit të primin nga ana e Shoqërisë. Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit të cilat kanë një efekt material mbi vlerën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë janë paraqitur më poshtë.

Sigurimi i Jetes per hua

Kontratat e klasifikuara si “Sigurim I Jetes per hua” janë përgjithësisht polica vjetore të rinovueshme që mbulojnë rrezikun e vdekjes dhe shiten nga bankat sëbashku me kredinë. Në disa raste, rreziku mbulohet pjeserisht si humbje aksidentale e jetes. Shuma e siguruar zvogëlohet paralelisht me ripagimin e kredisë.

Sigurimi i kombinuar
Sigurimi i kombinuar i jetes perbehet nga polica me te cilat kompania nenshkruan mbulimet ne grup. Kontratat e jetes me afat ofrojne pagesen e perfitimeve per humbjen e jetes te cilat jane shuma qe specifikohen ne kontrate dhe nuk varen nga gjykimi i kompanise. Kontratat leshohen per individe dhe grupe individesh.

5. MENAXHIMI I RREZIKUT TE SIGURIMIT (VAZHDIM)

c) Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit (vazhdim)

Jeta me kursim

"Jeta me kursim" përfshin sigurimin e jetës dhe gjithashtu perfshin edhe nje komponent kursimi. Përfitimet nga ky produkt i merr i siguruari nëse ai/ajo jeton në datën e maturimit të policës ose trashëgimtarët në rast të kundërt. Data e maturimit varion nga 3 në 25 vjet. Në rast të daljes nga sigurimi gjatë tre viteve të parë të policës, Shoqëria nuk ka asnjë detyrim ndaj policëmbajtësit. Pas kësaj periudhe, Shoqëria paguan vlerat e përcaktuara nga kushtet në policë. Produkti është afatgjatë dhe me përfitime të garantuara, madhësia e të cilave pritet të rritet në të ardhmen. Përfitimi në rast vdekje është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin dhe shumën e siguruar.

Risigurimi dhe përqëndrimi i rrezikut

Risigurimi përdoret për të menaxhuar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk heq përgjegjesinë e Shoqërisë si siguruesi kryesor. Nëse risiguruesi nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Shoqëria është e detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin. Aftësia paguese e risiguruesit analizohet çdo vit duke rishikuar pozicionin e tyre financiar përpara së të nënshkruajnë kontratën. Shoqëria ka ceduar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin nga humbjet nga kontratat e nënshkurara dhe të minimizojë efektin e humbjes nga sigurimi i jetës, duke nënshkruar kontrata risigurimi me SCOR Global Life.Tabela e mëposhtme tregon policat e nënshkruara në fund të vitit sipas moshës para dhe pas risigurimit. Analiza e këtyre ekspozimeve mendohet të jetë indikatori më i mirë për të treguar përqëndrimin e rrezikut të sigurimit.

	Jeta e debitorit		**Sigurimi i Jetës dhe Jetës së kombinuar**		**Jeta me kursim**	
	Në'000 Lek	**Në %**	**Në'000 Lek**	**Në %**	**Në '000Lek**	**Në %**
Mosha						
Deri në 29	8,866,060	10%	807,940	20,12%	786,650	14,15%
30 – 39	26,592,890	30.26%	1,250,288	31,14%	1,617,008	29,08%
40 – 49	29,336,686	33,38%	890,142	22,17%	2,252,351	40,50%
50 – 59	20,166,592	22,95%	755,640	18,82%	904,411	16,26%
Mbi 60	2,920,610	3.32%	310,848	7,74%	600	0,01%
Përpara risigurimit	**87,882,838**	**100%**	**4,014,858**	**100%**	**5,561,020**	**100%**
Minus pjesën e risigurimit	(43,910)		-		-	
Pas risigurimit	**87,838,928**		**4,014,858**		**5,561,020**	

d) Ekspozimi që lidhet me ngjarjet katastrofike

Shoqëria gjykon se gjatë aktivitetit të saj të sigurimit ajo nuk ka akumuluar një ekspozim te rendësishëm ndaj ngjarjeve katastrofike.
Transaksionet me instrumentat financiare rezultojnë në mbartjen e rrezikut financiar nga ana e Shoqërisë. Rreziku financiar përfshinë rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë (duke përfshirë rrezikun e kredisë nga risiguruesi) dhe rrezikun e likuiditetit. Secili nga këto rreziqe është i përshkruar më poshtë së bashku me një përmbledhje të mënyrave se si Shoqëria i menaxhon këto rreziqe.

5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

a) Market risk

Rreziku i tregut përfshin tre lloje rreziqesh:

Rreziku valutor – rreziku që vlera e instrumentave financiarë do të variojë nga ndryshimet në kurset e këmbimit.

Rreziku i vlerës së drejtë të normës së interest – rreziku që vlera e instrumentave financiare do të variojë nga ndryshimet në treg të normës së interesit.

Rreziku i çmimit – rreziku që vlera e instrumentave financiare do të variojë si rezultat i ndryshimeve të çmimeve të tregut, qofshin këto ndryshime si rezultat i faktorëve specifik të instrumentit financiar ose të emetusit të tij, ose faktorë që ndikojnë të gjithë instrumentat financiarë që janë në treg.Rreziku i tregut nuk përfshin vetëm mundësinë për të humbur por edhe mundësinë për të fituar.

Rreziku valutor

Shoqëria operon në katër monedha të ndryshme: Lek, Euro, USD dhe CHF. Rreziku i kurseve të këmbimit në portofolet e investimeve është i administruar duke përdorur parimin e përputhjes midis aktiveve dhe detyrimeve (shiko më poshtë detajimet). Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë kontratë për kryerjen e transaksioneve në valutë në të ardhmen ose produkte derivative të këtyre transaksioneve më 31 dhjetor 2013.

Përputhja aktive/detyrim

Shoqëria i menaxhon aktivet duke përdorur një mënyrë që balancon cilësinë, diversifikimin, përputhjen aktive-detyrim, likuiditetin dhe të ardhurat nga investimet. Qëllimi i procesit të investimit është që të optimizojë të ardhurat nga investimi ndërkohë që siguron që aktivet dhe detyrimet janë menaxhuar në bazë të fluksit të parave dhe zgjatjes së tyre.

Natyra e rrezikut të sigurimit, maturimi i tyre dhe struktura e monedhës së vendosur për të shprehur detyrimin kanë një ndikim tek strategjia e investimit të Shoqërisë. Gjithashtu Shoqëria duhet të plotësojë limitet e vendosura nga rregulluesit e sigurimeve të cilët kërkojnë që aktivet financiare të investuara në institucionet jo-financiare nuk duhet të kalojnë limitin prej 10% të kapitalit aksioner.

Shoqëria vendos objektiva për portofol akivesh për çdo produkt sigurimi, gjë që përfaqëson strategjinë e investimit të përdorur për të financuar detyrimet brënda niveleve të pranueshme të rrezikut. Këto strategji përfshijnë objektiva për kohëzgjatjen, ndjeshmërinë, likuiditetin, përqëndrimin e sektorit të aktiveve dhe cilësinë e kreditit. Llogaritjet e përdorura për të përcaktuar sasitë e përafërta dhe kohën e pagesave të detyrimeve ndaj të siguruarve vlerësohen rregullisht.

Shumica e këtyre llogaritjeve janë subjektive dhe mund të ndikojnë në aftësinë e Shoqërisë për të arritur objektivat e menaxhimit të aseteve/detyrimeve. Shoqëria ka ndërrmarrë disa transaksione në monedhë të huaj dhe si rrjedhim është e ekspozuar ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit.

Shoqëria ka një ekspozim minimal ndaj rrezikut valutor sepse aktivet financiare, kryesisht përputhen me detyrimet e sigurimit dhe kontratat e investimeve në të njëjtat monedha. Si rezultat, rreziku nga këmbimet valutore lind nga aktive dhe detyrime të tjera në monedha të ndryshme.

5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2013 janë si më poshtë:

AKTIVET	Në Lek	Në EUR	Në USD	Në CHF	TOTALI
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	12,124	39,455	1,574	6	**53,159**
Depozita me afat	147,511	648,344	83,557	-	**879,412**
Investime në letra me vlerë	203,029	179,681	-	-	**382,710**
Llogaritë e arketueshme të sigurimit e të tjera	12,124	10,947	9	-	**23,080**
Aktive të risigurimit	521	5,268	1,935	-	**7,724**
TOTALI I AKTIVEVE FINANCIARE	**375,309**	**883,695**	**87,075**	**6**	**1,346,085**
DETYRIMET					
Rezervat për kontratat e sigurimit	305,871	458,644	24,885	-	**789,400**
Llogari të pagueshme për risigurimin	-	1,757	-	-	**1,757**
Llogari të pagueshme për sigurimin dhe të tjera	9,598	12,960	18	-	**22,577**
TOTALI I DETYRIMEVE FINANCIARE	**315,469**	**473,361**	**24,903**	**-**	**813,733**
POZICIONI NETO	**59,840**	**410,334**	**62,172**	**6**	

Aktivet dhe detyrimet financiare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2012 janë si më poshtë:

AKTIVET	Në Lek	Në EUR	Në USD	Në CHF	TOTALI
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	5,485	32,370	622	669	**39,146**
Depozita me afat	90,073	628,695	129,995	-	**848,763**
Investime në letra me vlerë	75,262	131,575	-	-	**206,837**
Llogaritë e arketueshme të sigurimit e të tjera	9,323	7,591	79	-	**16,993**
Aktive të risigurimit	714	6,279	2,290	-	**9,283**
TOTALI I AKTIVEVE FINANCIARE	**180,857**	**806,510**	**132,986**	**669**	**1,121,022**
DETYRIMET					
Rezervat për kontratat e sigurimit	277,530	357,737	19,828	8,682	**663,777**
Llogari të pagueshme për risigurimin	-	2,504	-	-	**2,504**
Llogari të pagueshme për sigurimin dhe të tjera	9,392	9,497	18	-	**18,907**
TOTALI I DETYRIMEVE FINANCIARE	**286,922**	**369,738**	**19,846**	**8,682**	**685,188**
POZICIONI NETO	**(106,065)**	**436,772**	**113,140**	**(8,013)**	

5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Kurset e këmbimit të përdorura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë (Lek ndaj monedhave të huaja) të paraqitura si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Dollari i Shteteve të Bashkuara (USD)	101.86	105.85
Monedha e Bashkimit Europian (EUR)	140.20	139.59
Franga Zvicerane (CHF)	114.41	115.65

Analiza e ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të kurseve të këmbimit është si me poshtë:

	Ndikimi	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
EUR rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	41,033	43,677
EUR ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(41,033)	(43,677)
USD rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	6,217	11,314
USD ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	6,217	(11,314)

Supozimet mbi ndryshimin e kurseve të këmbimit janë vlerësimet më të mira të drejtimit të bazuara në të dhënat e vëzhguara dhe tendencave pas datës së raportimit**Rreziku i normave të interesit**
Rreziku i normave të interesit është rreziku që vlera e instrumentave financiare do të luhatet si rezultat i ndryshimit të normave të interesit në treg si dhe rreziku që maturiti i interesave në lidhje me aktivet ndryshojnë nga maturiteti i interesave lidhur me detyrimet e përdorura financimin e këtyre aktiveve. Periudha për të cilën norma e interesit të një instrumenti financiar është e fiksuar tregon dhe ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit. Aktivet e Shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut.

Shoqëria nuk ka detyrime që mbartin interes dhe rreziku i rritjes së kostos së detyrimeve si rezultat i rritjes së normave të interesit nuk është i qenësishëm më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012, ndërkohë që normat e interesit të aktiveve janë norma fikse.

b) Rreziku i kredisë

Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë për aktivet financiare si: depozitat me afat, investimet në letra me vlerë, llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë për aktivet finanicare nuk është i qenësishëm. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Mjete monetare dhe ekuivalente	53,159	39,146
Depozita me afat	879,412	848,763
Investime në letra me vlerë	382,710	206,837
Llogaritë e arketueshme të sigurimit e të tjera	23,080	16,993
Aktive të risigurimit	7,724	9,283
TOTAL	**1,346,085**	**1,121,022**

5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Shoqëria manaxhon eksposimin e saj ndaj rrezikut të kredisë në mënyrë sistematike duke monitoruar llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi, ajo ka krijuar një rregull të brendshëm ku të gjitha policat e papaguara brenda dy muajve anullohen, përveç rasteve ku ka siguri që shuma e arkëtueshme do të mblidhet. Llogaritë e arkëtueshme sipas maturitetit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
As të vonuara as të zhvlerësuara	23,080	16,993
Te vonuara por jo të zhvlerësuara	-	-
Të zhvlerësuara	-	-
TOTALI	**23,080**	**16,993**

	31 dhjetor 2013	%	31 dhjetor 2012	%
1-3 Muaj	23,080		16,993	100%
3-12 Muaj	-		-	-
Më shumë se 12-Muaj	-		-	-
TOTALI	**23,080**		**16,993**	**100%**

Shoqëria nuk ka identifikuar indikacione objektive për zhvlerësim e mjeteve të tjera financiare në datën e raportimit, prandaj menaxhimi i konsideron aktivet e tjera financiare si ekuivalentë të mjeteve monetare, depozitat me afat dhe pasuritë e tjera si as të kaluara e as e zhvlerësuara.

Shoqëria ka vendosur proçedura të brendshme nga ku risiguruesit mund të kenë klasifikime BBB- ose më të lartë dhe rreziku është i monitoruar nga personeli i risigurimeve. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumentave të borxhit dhe depozitave.

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është i pranishëm në biznesin e Shoqërisë pasi aktivet e blera dhe detyrimet e shitura kanë karakteristika likuiditeti specifike. Nëse Shoqërisë do t'i nevojiteshin likuiditete të mëdha brenda një kohe të shkurtër, do të ishte e vështirë të kishte çmime të favorshme.

Megjithatë Shoqëria mund të marrë borxhe pasi ajo nuk ka asnjë detyrim afatgjatë në 31 dhjetor 2013. Bazuar në këtë analizë manaxhimi beson se nuk do të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve financiare. Gjithashtu Shoqëria e monitoron gjëndjen e saj të likuiditetit çdo ditë, për të përmbushur detyrimet në kohën e duhur. Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2013 është si më poshtë:

	Më pak se 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 deri në 5 vjet	Totali
AKTIVET					
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	46,159	7,000			**53,159**
Depozita me afat	30,084	316,847	464,033	68,448	**879,412**
Investime në letra me vlerë	10,981	13,811	72,302	285,616	**382,710**
Llogaritë e arketueshme të sigurimit e të tjera	21,926	1,154	0	0	23,080
Aktive të risigurimit	33	276	7,407	8	**7,724**
TOTALI I AKTIVEVE FINANCIARE	**108,680**	**339,088**	**543,742**	**345,072**	**985,448**
DETYRIMET					
Rezervat teknike për dëmet	1,816	14,471	256,047	517,066	**789,400**
Llogari të pagueshme për sigurimin dhe të tjera	22,577	0	0	0	**22,577**
Llogari të pagueshme për risigurimin	0	1,757	0	0	**1,757**
TOTALI I DETYRIMEVE FINANCIARE	**24,393**	**16,228**	**256,047**	**517,066**	**813,734**
POZICIONI NETO	**84,287**	**322,860**	**287,695**	**(171,994)**	**522,848**
HENDEKU KUMULATIV	**84,287**	**407,147**	**694,842**	**522,848**	

5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

c) Rreziku i likuiditetit

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2012 është si më poshtë:

	Më pak se 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 deri në 5 vjet	Totali
AKTIVET					
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	39,146	-	-	-	**39,146**
Depozita me afat	10,612	301,006	537,145	-	**848,763**
Investime në letra me vlerë	9,982	11,836	185,019		**206,837**
Llogaritë e arketueshme të sigurimit e të tjera	16,143	850	-	-	**16,993**
Aktive të risigurimit	29	779	8,475	-	**9,283**
TOTALI I AKTIVEVE FINANCIARE	**75,912**	**314,471**	**730,639**	**-**	**1,121,022**
DETYRIMET					
Rezervat teknike për dëmet	24,059	40,841	148,157	450,720	**663,777**
Llogari të pagueshme për sigurimin dhe të tjera	18,907	-	-	-	**18,907**
Llogari të pagueshme për risigurimin	-	2,504	-	-	**2,504**
TOTALI I DETYRIMEVE FINANCIARE	**42,966**	**43,345**	**148,157**	**450,720**	**685,188**
POZICIONI NETO	**32,946**	**271,126**	**582,482**	**(450,720)**	**435,834**
HENDEKUKUMULATIV	**32,946**	**304,072**	**886,554**	**435,834**	

d) Interesi Teknik

Norma e interest teknik në intervalin 2-6%, e ndryshme për çdo monedhë, përdoret për të llogaritur rezervën. Norma e interesit teknik është minimumi i kthimit të garantuar për cdo kontratë sigurimi për jetën. Ka një rrezik që të ardhurat nga investimet nuk do të mbulojnë minimumin e kthimeve të garantuara. Në 2013, të ardhurat neto të gjeneruara nga investimet (duke përfshirë edhe rezervën matematikore) mbulojnë minimumin e të ardhurave të garantuara, duke siguruar fitime shtesë mbi interesin teknik. Analizat e parametrave aktuarialë të përdorura në llogaritjen e tarifave dhe rezervave për sigurimin e jetës tregojnë që supozimet e bëra janë të besueshme dhe të sakta.

e) Rezervat dhe testi i mjaftueshmërisë për supozimet aktuariale

Shoqëria llogarit dhe ngarkon rezervat e sigurimit për jetën (rezervat matematikore) për të paraqitur pagesat e ardhshme nën policat e sigurimt me afat të gjatë. Shumë faktorë ndikojnë llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë vdekshmërinë, anullimet dhe interesin teknik. Rezerva për sigurimin e jetës është llogaritur në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë.

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve është i limituar në analizën e parametrave kryesorë të cilat kanë ndikimin më të madh në llogaritjen e rezervës.

“Vdekshmëria” është rreziku që mbulohet nga të gjithë produktet e sigurimit që Shoqëria ka. Të dhënat për rrezikun e “vdekshmërisë” për 2013 janë si më poshtë:

Numri i personave të prekshëm nga rreziku i vdekjes	55,692 njerëz
Mosha e personave të prekshëm nga rreziku i vdekjes	18-71 vjeç
Numri i pagesave për të siguruarit që kanë vdekur gjatë 2012	23 raste
Invervali i numrit të vdekshmërisë të llogaritur në 1000 njerëz	0.14 deri në 47.53
Numri i vdekshmërisë në 1000 njerëz	0.41299

Kështu që, rreziku i “vdekshmërisë” i paraqitur në këtë tabelë është brenda pritshmërisë.

5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

f) Rreziku i risigurimit

Shoqëria cedon rrezikun e sigurimit që të limitojë ekspozimin e humbjeve nën marrëveshje të ndara për cdo lloj sigurimi. Këto marrëveshje risigurimi e shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Shuma e secilit rrezik të mbetur varet nga vlerësimi që Shoqëria i bën rreziqeve specifike, I cili është subjekt në disa rrethana, i limiteve maksimale bazuar në karakteristikat e mbulimit. Nën termat e marrëveshjes së risigurimit, risiguruesi bie dakort që të rimbursojë shumën e ceduar në rastin e dëmeve të paguara. Megjithatë, Shoqëria mbetet e detyruar ndaj policëmbajtësve të saj në lidhje me sigurimin e ceduar nëse risiguruesi nuk përmbush detyrimet e tij.

Kur zgjedh risiguruesin Shoqëria merr në konsideratë sigurinë e tij. Siguria e risiguruesit vlerësohet nga informacionet publike të kategorizimeve dhe nga investigime të brëndshme. Risiguruesi aktual ka një vlerësim A nga “Standard and Poor’s”.

g) Analiza e sensitivitetit

Faktorët kryesorë të cilët ndikojnë fitimin e Shoqërisë janë niveli i dëmeve dhe shpenzimet.

Situata më 31 dhjetor 2013	Fitimi (Humbja)	Kapitali neto	Fondet e garancisë së detyrueshme
Kapitali neto			
Aktual	148,140	666,704	370,000
Rritje në dëmet e ndodhura	(27,991)	638,713	370,000
Rritje në shpenzime (+10%)	(4,308)	634,405	370,000

Tabela më sipër paraqet një simulim, duke marrë në konsideratë ndryshime drastike për dëmet e ndodhura ose rritje në shpenzime dhe efekti i saj në kapitalin neto të Shoqërisë dhe aftësinë paguese në dispozicion. Për qëllime të simulimit, modeli përdor një rritje të dëmeve të barabartë me dëmin më të madh të ndodhura gjatë dy viteve të fundit dhe një rritje të shpenzimeve administrative prej 10%.

Menaxhimi i kapitalit

Objektivat kryesore të Shoqërisë për menaxhimin e kapitalit janë:

- të jetë në përputhje me kërkesat nga entet rregullatore Shqiptare për tregun e sigurimit duke mbajtur kapital mbi limitin e kërkuar;
- të sigurojë mundësinë e vijimësisë së aktivitetit të Shoqërisë në mënyrë që ajo të mund të gjenerojë fitime për aksionerët dhe përfitime për grupet e interesit të tjera.

Në përputhje me nenin 93 të ligjit 9267 datë 24 korrik 2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, Shoqëria e sigurimit krijon dhe mban çdo vit financiar rezervën e sigurisë në nivelin jo më pak se 1/3 e fitimit të vitit ushtrimor, nëse fitimi nuk përdoret për mbulimin e humbjeve të trashëguara nga vitet e mëparshme

6. PERDORIMI I VLERESIMEVE DHE GJYKIMEVE

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që influencojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve gjatë një viti fiskal. Vlerësimet dhe gjykimet janë rishikuar rregullisht dhe janë bazuar në informacionet e tregut dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhëshme që besohet të jenë të arsyeshme në rrethanat e caktuara.

(i) Llogaritja e detyrimit nga sigurimi

Shiko notën 3.d.

(ii) Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat

Duke filluar që nga 1 janari 2008 Shoqëria ka filluar aplikimin e Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Aplikimi i Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar jep bazën për regjistrimet kur një njësi ekonomike është subjekt i tatimit mbi të ardhurat. Megjithatë, në datën e përgatitjes të këtyre pasqyrave financiare ka disa amendimeve të kufizuara për tatimin aktual mbi të ardhurat dhe udhëzime për llogaritjen e tatimit mbi fitim. Menaxhimi beson që provigjionimi i tatimi mbi të ardhurat është i drejtë dhe duke pasur parasysh pasigurinë e ambjentit të taksave në Shqipëri dhe legjislacionin ekzistues dhe çdo kontroll tatimor i ardhshëm nuk do të ketë ndonjë efekt në pozicionin financiar të Shoqërisë, rezultatin e veprimtarisë, ose në flukset e mjeteve monetare.

7. PARAQITJA E VLERES SE DREJTE

Politikat kontabël për matjen e vlerës së drejtë janë paraqitur në notën 3.e.(vi). Kompania përdor renditjen e mëposhtme për matjen e vlerës së drejtë, e cila paraqet rëndësinë e të dhënave për të kryer matjen e saj:

-Niveli 1: Cmimi i tregut (i parregulluar) për instrumenta të njëjte.

-Niveli 2: Teknikat e vlerësimit të bazuara në elemetet e vëzhgueshëm, në mënyrë direkte ose jo direkte (p.sh. që rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar nëpërmjet çmimeve të instrumenteve të ngjashëm të kuotuar në tregje aktive; çmimet e kuotuar të instrumenteve të njëjta ose të ngjashme në tregje jo shumë aktive; ose teknika të tjera vlerësimi, ku të gjithë elementet e rëndësishme vëzhgohen në mënyrë direkte ose jo direkte nga të dhënat e tregut.
-Niveli 3: Teknikat e vlerësimit të cilat përdorin të dhëna të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat teknika e vlerësimit të të cilave përfshin informacione të cilat nuk janë të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumenta, vlera e të cilave, është e bazuar në cmimin e listuar për instrumenta të ngjashëm por të cilët përfshijnë supozime ose rregullime të pavëzhgueshme.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë modelin e vlerës neto dhe të flukseve të skontuara dhe krahasimin me instrumenta të ngjashëm për të cilat egzistojnë cmime të evidentueshme tregu dhe të cilat janë bazuar në kurbën e përshtatshme të interesave për maturitetin e mbetur. Supozimet dhe të shënat e tjera të përdorura në teknikat e vlerësimit përfshijnë normat e interest të tregut, normat e interesit pa risk, normat e kreditimit pë primin e sigurimit përdorur për llogaritjen e normës së skontimit, kursin e këmbimit, fluktuacionet në cmimin e instrumentave të kapitalit dhe korelacinin midis tyre. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijnë në përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumentit financiar në date e raportimit.

Llogaritjet e vlerës së drejtë janë bazuar në instrumentat financiarë ekzistues në pasqyren e pozicionit financiar, pa u përpjekur që të llogaritet vlera e ardhshme e biznesit dhe vlera e aktiveve dhe detyrimeve të cilat nuk konsiderohen instrumenta financiarë.

Detyrime nga llogaritë bankare - Detyrime nga llogaritë bankare, të cilët përbëhen nga mjete monetare dhe depozita me afat, përfshijnë gjendje midis bankave dhe llogari që pritet të mbidhen. Meqë depozitat janë me afat të shkurtër dhe me norma interesit të ndryshueshme, vlera e tyre reale konsiderohet të jetë e përafërt me vleren e mbartur.

Instrumentat e investimit - Bonot e Thesarit dhe obligacionet janë aktive që mbahen deri në maturim dhe me interes. Aktualisht nuk ekziston një treg aktiv për tregtimin e tyre dhe vlera reale është llogaritur duke përdorur modelin e zbritshëm të fluksit te parasë duke u bazuar në interesin përkatës për periudhën e mbetur deri në maturim.

7. PARAQITJA E VLERES SE DREJTE (VAZHDIM)

	Të mbajtura deri në maturim	Kreditë dhe të arkëtueshmet	Të tjera me kosto të amortizuar	Totali i vlerës së mbartur
31 dhjetor 2013				
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	-	53,159	-	53,159
Depozita me afat	-	879,412	-	879,412
Investime në letra me vlerë	382,710	-	-	382,710
31 dhjetor 2012				
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	-	39,146	-	39,146
Depozita me afat	-	848,763	-	848,763
Investime në letra me vlerë	206,837	-	-	206,837

8. MJETE MONETARE

Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Mjete monetare në bankë në EUR	39,455	7,104
Mjete monetare në bankë në LEK	5,124	5,485
Mjete monetare në bankë në USD	1,574	582
Mjete monetare në bankë në CHF	6	669
Mjete monetare në bankë në GBP	-	40
Depozita me afat me maturim më pak se tre muaj	7,000	25,266
TOTALI	**53,159**	**39,146**

Depozita me afat me maturim më pak se tre muaj, janë klasifikuar si mjete monetare dhe të tjera ekuivalente. Depozita me afat me maturim më pak se tre muaj është një depozitë e shprehur në LEK, me maturitet 3 muaj dhe gjeneron një normë interesi vjetore në 2.3%.Të gjitha mjetet monetare në arkë dhe në bankë, plotësojnë përkufizimin e mjeteve monetare dhe të tjera ekuivalente.

9. DEPOZITA ME AFAT

Depozitat me afat me 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Depozita për fondin e garancisë	397,845	394,141
Depozita me afat	461,073	436,585
Interesi përllogaritur	20,494	18,037
TOTALI	**879,412**	**848,763**

Në përputhje me nenin 3 të Ligjit Nr. 9685 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9267, datë 29 korrik 2004 Mbi aktivitetin e Sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësit ne sigurime dhe risigurime”, datë 26 shkurt 2008 lidhur me fondin e garancisë, Shoqëria mban të bllokuar për fondin e garancisë minimalisht vlerën më të lartë midis 1/3 të nivelit të detyrueshëm të marzhit të aftësisë paguese dhe 370,000 mijë Lek, në bono thesari dhe depozita me afat maturimi jo më pak se 1 vit. Fondi i garancise më 31 dhjetor 2013 është 397,845 mijë Lek (2012: 394,141 mijë Lek).

Aktivet financiare të klasifikuara sipas monedhës për vitin 2013 dhe 2012 janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2013	Norma interesit	31 dhjetor 2012	Norma interesit
		%		%
Në EUR	633,883	2.5 - 4.50	614,941	0.7 - 4.50
Në USD	82,372	2.0 - 4.00	128,171	2.2 - 4.00
Në LEK	142,664	2.3 - 6.30	87,614	6.0 - 6.85
Interes i përllogaritur	20,494		18,037	
TOTALI	**879,412**		**848,763**	

Të gjitha depozitat, duke përfshirë edhe depozitat e bllokuara për fondin e garancisë, sipas kushteve të përgjithshme kontraktuale kanë maturitet 12 mujor dhe 24 mujor. Depozitat me maturitet tre mujor, janë përfshirë në zërin "Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente".

10. INVESTIME NE LETRA ME VLERE

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Vlera nominale	383,017	214,996
Zbritja e paamortzuar	(307)	(8,159)
Vlera neto	**382,710**	**206,837**

Investimet në letra me vlerë më 31 dhjetor 2013 janë bono thesari dhe obligacione të Qeverisë së Shqiperisë në Euro dhe Lek me maturitet prej një viti deri në 7 vjet dhe normë interesi nga 3.74- 7.45% (2012: 5- 7.35%).

11. INVESTIMI NE FILIALE

Në 15 dhjetor 2010, Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a firmosi një marrëveshje për blerjen e aksioneve të Capital Sh.a në masën 51% të aksioneve. Capital Sh.a ("Fondi") është një entitet shqiptar, e cila menaxhon një fond vullnetar të pensioneve. Finalizimi i transaksionit është i kushtëzuar nga pëmbushja e kënaqshme e kushteve të mëposhtme:
-Mosmarrjen e ndonjë kundershtimi nga Autoriteti i Konkurencës
-Aprovimin e transaksionit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; dhe
-Marrjen e liçenses nga autoritet përgjegjëse.

Më 31 mars 2011 të gjitha kushtet e sipërmendura u plotësuan dhe transferimi i aksioneve u regjistrua në prill 2011. Çmimi i blerjes u vendos 1 Euro, ndërsa pjesa tjetër e aksioneve mund të blihet nga Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a duke ushtruar opsion për blerje mbasi të jetë bërë vlerësimi i aktivitetit të Fondit. Në këto pasqyra financiare të veçanta, Shoqëria e ka paraqitur këtë investim kapitali me koston historike, meqenëse ky instrument është i pakuotuar dhe nuk ka një çmuarje të besueshmë të vlerës së tregut. Opsioni për blerje lidhur me këtë investim kapitali, i cili pritet që të ushtrohet duke transferuar këtë instrument kapitali të pakuotuar është çmuar dhe vlera më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 është zero.

Duke u pajtuar me vendimin nr 6 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, në datë 30 Mars 2012, për të rritur kapitalin aksionar të Filialit me Lek 19,028,400, Shoqëria bëri një kontribut prej Lek 9,701 mijë për pjesën e saj të aksioneve. Rritja e kapitalit aksioner të Filialit u rregjistrua në Qendrën Kombetare të Rregjistrimit, më 24 Shtator 2012.

12. KOSTO TE SHTYRA TE MARRJES NE SIGURIM

Për produktin PPI, kosto të shtyra të marrjes në sigurim përfaqësojnë komisionet si përqindje e primit të shkruar dhe detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2013		31 dhjetor 2012	
	Në %		Në %	
Vdekje aksidentale dhe hipotekat	34%-79%	106,519	34%-79%	110,164
Humbja aksidentale e jetës dhe invaliditeti	25%	4,464	25%	3,878
TOTALI		**110,983**		**114,042**

13. LLOGARITË E ARKETUESHME TË SIGURIMIT E TË TJERA

Llogaritë e arketueshme të sigurimit e të tjera janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Llogari të arkëtueshme nga policë-mbajtësit	22,496	16,954
Të tjera të arkëtueshme	584	39
TOTALI	**23,080**	**16,993**

14. AKTIVE AFATEGJATA MATERIALE

Lëvizjet në ndërtesa dhe paisje gjatë vitit 2013 dhe 2012 janë si më poshtë:

	Ndërtesa	Mjete Transporti	Pajisje kompjuterike	TOTALI
Kosto				
Më 1 Janar 2012	**14,773**	**4,418**	**964**	**20,155**
Shtesa	-	-	176	**176**
Pakësime	-	(87)	-	**(87)**
Më 31 dhjetor 2012	**14,773**	**4,331**	**1,140**	**20,244**
Shtesa	-	-	364	**364**
Pakësime	-	-	-	**-**
Më 31 dhjetor 2013	**14,773**	**4,331**	**1,504**	**20,608**
Amortizimi i akumuluar				
Më 1 Janar 2012	**555**	**1,812**	**348**	**2,714**
Shpenzimi i vitit	710	521	164	**1,395**
Pakësime	-	(45)	-	**(45)**
Më 31 dhjetor 2012	**1,265**	**2,288**	**512**	**4,065**
Shpenzimi i vitit	674	409	159	**1,242**
Pakësime	-	-	-	**-**
Më 31 dhjetor 2013	**1,939**	**2,697**	**671**	**5,307**
Vlera kontabël neto:				
Më 31 dhjetor 2012	**13,508**	**2,043**	**628**	**16,179**
Më 31 dhjetor 2013	**12,834**	**1,634**	**833**	**15,301**

Sipas kontratës së qirasë me SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a, Shoqëria përdor ambientet e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a në shkëmbim të pagesave mujore të qirasë. Shpenzimet e qirasë për zyrën qëndrore përfshirë te zëri “Shërbime të jashtme” pjesë e “Shpenzime të tjera operative” në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave janë 3,369 mijë Lek (2012: 2,880 mijë Lek).

15. REZERVAT PER KONTRATAT E SIGURIMIT DHE AKTIVET NGA RISIGURIMI

Rezervat për kontratat e sigurimit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Rezerva për dëmet pezull	94,980	81,914
Rezerva për IBNR	18,023	24,390
Kostot e trajtimit të dëmeve	5,650	5,315
Detyrimet për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen	**118,653**	**111,619**
Rezerva për sigurimin e jetës	172,229	123,973
Rezerva për sigurimin e jo-jetës	204,659	214,046
Rezerva për jetën me kursim	78,929	62,754
Rezerva për primin e pafituar	**455,816**	**400,773**
Të rikuperueshme nga risiguresit		
Rezerva për sigurimin e jetës	(4,255)	(6,126)
Rezerva për sigurimin e jo-jetës	(3,469)	(3,157)
Pjesa e risiguruesit në detyrimet e sigurimit	**(7,724)**	**(9,283)**
Të tjera (matematikore) rezerva	**214,931**	**151,385**
Rezerva per kontratat e sigurimit, neto	**781,677**	**654,494**

15. REZERVAT PER KONTRATAT E SIGURIMIT DHE AKTIVET NGA RISIGURIMI (VAZHDIMI)

Provigjionet teknike të sigurimit dhe risigurimit të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2013 janë të aprovuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bazuar nл Vendimin nr. 32 datë 25 mars 2014, në përputhje me nenin 101, 111 dhe 112 paragrafi 1 (ç) të ligjit nr. 9267 datë 29 korrik 2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe me nenin 14 paragrafi 9 të ligjit nr. 9572 datë 3 korrik 2006 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare”.

Lëvizjet në rezervat për kontratat e sigurimit janë përmbledhur më poshtë:
Rezerva për demet

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Më 1 janar		
Detyrimet për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen, bruto	111,619	81,955
Risigurime të rikuperueshme	-	-
Detyrimet për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen, neto	**111,619**	**81,955**
Detyrimet për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen, të ndodhura	40,288	114,020
Detyrimet për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen, të paguara	(33,254)	(84,356)
Detyrimet për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen, neto në 31 dhjetor	**118,653**	**111,619**
Risigurime të rikuperueshme	-	-
Detyrimet për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen	**118,653**	**111,619**

15. REZERVAT PER KONTRATAT E SIGURIMIT DHE AKTIVET NGA RISIGURIMI

Rezerva për primet

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Më 1 Janar	400,773	422,895
Primet e shkruara gjatë vitit (shënimi 19)	579,889	450,603
Minus: primet e fituara gjatë vitit	(524,846)	(472,725)
Më 31 Dhjetor	**455,816**	**400,773**

16. LLOGARI TE PAGUESHME PER RISIGURIMIN

Llogari të pagueshme për risigurimin janë të detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
SCOR Global Life	1,757	2,504
TOTALI	**1,757**	**2,504**

Llogaritë e pagueshme vijnë nga kontratat e risigurimit të nënshkruara nga Shoqëria, ato mbulojnë rrezikun nga kontratat e sigurimit të jetës dhe nga aksidentet personale.

17. LLOGARI TE PAGUESHME PER SIGURIMIN DHE TE TJERA

Llogari të pagueshme për sigurimin dhe të tjera përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Llogari të pagueshme sigurimi dhe të tjera	12,323	11,783
Klient kreditore	8,255	5,245
Detyrime të tjera	1,999	1,037
Tatim mbi të ardhurat personale për t'u paguar	293	344
Detyrime ndaj agjentëve	51	149
Kontributi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	317	335
Tatimi në burim	52	14
TOTALI	**23,290**	**18,907**

18. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2013 është 370,000,000 Lek (2012: 370,000,000 Lek). Kapitali aksionar është i përbërë nga 370,000 (2012: 370,000) aksione plotësisht të paguara me një vlerë nominale prej 1,000 Lek secili (2012: 1,000 Lek). Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 struktura e aksionarëve është si më poshtë:

		31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
	Në %	**Në '000 Lek**	**Në '000 Lek**
SIGAL UNIQA Group Austria sh.a	99,9997%	369,999	369,999
UNIQA International Beteiligungs Verwaltungs GmbH	0.0003%	1	1
TOTALI	**100%**	**370,000**	**370,000**

Rezerva e rrezikut të sigurimit

Rezerva e rrezikut të sigurimit është krijuar në bazë të nenit 93 të Ligjit të Sigurimit në shumën e një të tretës të fitimit të vitit paraardhës nëse ai nuk është përdorur për të mbuluar humbjet e trashëguara nga vitet e mëparëshme. Kjo rezervë nuk rritet më shumë se 30% e shumës mesatare të primeve të shkruara neto gjatë dy viteve të fundit.

Gjatë 2013, Shoqëria ka rritur rezervën e rrezikut të sigurimit me 30,670 mijë LEK që përfaqëson 1/3 e fitimit të 2012 (2012: Lek 32,923 mijë ekuivalent me 1/3 e fitimit të 2011).

19. PRIMET E SHKRUARA BRUTO

Primet e shkruara bruto sipas llojit të produktit janë detajuar më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Sigurim Jeta e debitorit	248,579	215,938
Sigurim Jete, PPI	182,180	99,837
Sigurim Jeta me kursim	129,075	109,244
Sigurim Jeta e kombinuar	20,055	25,584
TOTALI	**579,889**	**450,603**

20. KOSTOT E MARRJES NE SIGURIM

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Komisione ndërmjetësit-broker	39,035	31,355
Komisione të bankave	54,175	46,633
Komisione të agjentëve	24,487	20,958
Komisione PPI	121,132	65,739
Ndryshimi në DAC	3,060	16,888
Teste mjekesore	188	168
Policat e blera	727	531
TOTALI	**242,804**	**182,272**

21. SHPENZIME ADMINISTRATIVE DHE PER MARKETING

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Shpenzime personeli	31,755	31,231
Shërbime të jashtme	7,279	6,802
Shpenzime marketingu dhe promocioni	1,065	951
Shpenzime udhëtimi dhe transporti	1,243	1,329
Shpenzime amortizimi	1,273	1,395
Posta dhe telekomunikacioni	467	392
TOTALI	**43,082**	**42,100**

22. SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Shpenzimet për kontributin ndaj Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare	5,637	3,745
Gjoba dhe penalitete	-	522
Taksa lokale	41	35
Humbja nga nxjerrja jashtë përdorimi i aktiveve	-	42
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	36	6
Të tjera	2,327	2,873
TOTAL	**8,041**	**7,223**

23. TATIM FITIMI

Tatim fitimi në Shqipëri ka një normë 10% (2012: 10%) të fitimit të tatueshëm. Shpenzimi i tatim fitimit përbehet si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Tatim korrent	16,508	10,304
Tatim Fitimi	**16,508**	**10,304**

Parapagimet për tatim fitimin për vitin korrent janë netuar kundrejt detyrimit për tatimin fitimin e vitit korrent paraqitur në zërin e "Tatimit fitimi i pagueshëm".

Llogaritjet e tatim fitimit me normat e aplikueshme të taksave janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Fitimi para tatimit	164,648	102,315
Shpenzime të pazbritshme	433	725
Penalitete dhe shpenzime të tjera të pazbritshme	397	719
Shpenzime borxh i keq	36	6
Fitimi i tatueshëm	**165,081**	**103,040**
Tatim fitimi i llogaritur me 10%	**16,508**	**10,304**

24. DETYRIME DHE TE DREJTA TE KUSHTEZUARA DHE ANGAZHIME

Çështje ligjore

Nuk ka çështje ligjore të pazgjidhura më 31 dhjetor 2013.

Angazhime

Shoqëria ka hyre ne angazhime per qira për ambjentet e zyrës qëndrore të cilat rinovohen çdo vit. Pagesat minimale të ardhshme brenda një viti që rrjedhin nga kjo kontratë janë 8,400 mijë Lek (2012: 2,680 mijë Lek).

25. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

Palët konsiderohen të jenë të lidhura nëse njëra palë ka aftësinë të kontrollojë ose ushtrojë influencë domethënëse mbi pjesën tjetër për të marrë vendime financiare ose operuese, ose palët janë nën kontrollin e përbashkët me Shoqërinë.
Shoqëria ka ndërrmarrë një numër transaksionesh me palët e lidhura gjatë aktivitetit të zakonshëm. Këto transaksione janë mbartur mbi terma tregtare dhe në normat e tregut. Volumi i këtyre transaksioneve dhe gjëndjet pezull në fund të periudhave përkatëse janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Pasqyra e pozicionit financiar		
Të pagueshme ndaj SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a	1,318	497
Pasqyra e ndryshimeve në kapital		
Dividenti i paguar ndaj SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a	61,341	65,847
Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave		
Shpenzime për stafin manaxherial	11,757	11,743
Të ardhura nga qiraja prej SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a	240	240
Kosto manaxhimi	514	801
Qira vjetore për SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a	3,369	2,880

26. NGJARJET PAS DATES SE RAPORTIMIT

Menaxhimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime ose sqarime shtesë në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013.

Skedule Suplementare

I) AFTESIA PAGUESE

Shuma e kërkuar e fondit të garancisë në përputhje me ligjin nr. 9685 datë 26 Shkurt 2007, duhet të jetë maksimumi ndërmjet 1/3 të nivelit të aftësisë paguese dhe 370,000,000 Lek që prej 30 shtatorit 2008. Niveli aktual i fondit të garancisë më 31 dhjetor 2013, është brenda nivelit të kërkuar.

Aftësia paguese duke përdorur metodën e llogaritjes me bazë primet, më 31 dhjetor 2013 është si më poshtë:

		Shuma në'000 Lek
1	Kapitali aksionar i paguar (derdhur)	370,000
2	Rezervat që nuk u korrespondojnë përgjegjësive të marrjes në sigurim:	
	Rezerva ligjore	-
	Rezerva të lira.	-
3	Rezerva e sigurisë, që nuk i përket drejtpërsëdrejti kontratave të sigurimit në fuqi ose atyre që kanë qenë në fuqi	148,564
4	Fitime të mbartura:	
	Të mbartura nga vitet e mëparshme,	-
	Fitime të pashpërndara për vitin ushtrimor.	148,140
5	Me kërkesën e shoqërisë së sigurimit dhe paraqitjen prej saj të provave të mjaftueshme, rezervat (plus vlerat) e fshehura që rrjedhin nga nënvlerësimi i aktiveve, për aq sa këto rezerva (plus vlera) të fshehura nuk kanë natyrë jo të zakonshme	-
6	Vlera e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara sipas bilancit:	-
7	Rezerva që rezultojnë nga rivlerësimi i aktiveve:	
	Totali (1 + 2 + 3 + 4 + 5 – 6+7)	**666,704**
	Niveli aktual i aftësisë paguese	**666,704**
	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese	**100,284**
	Niveli i kërkuar i fondit të garancisë	**370,000**

Niveli aktual i Fondit të garancisë prej 397,845 mijë Lek më 31 dhjetor 2013 është brenda niveleve të kërkuara (2012: 394,141 mijë Lek).

II) AKTIVET NE MBULIM TE PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE

Në përputhje me vendimin e qeverisë Nr. 96 datë 3 shkurt 2008; amenduar me Vendimin nr 5, datë 7 Janar 2009; shoqëritë e sigurimit mund të investojnë jo më shumë se normat e mëposhtme të aktiveve dhe investimeve për të mbuluar rezervën teknike dhe matematike:

			31 Dhjetor 2013
Provigjione teknike dhe matematike bruto			**789,400**
	Kufiri i investimeve në raport me provigjonet	**Kufiri i investimit në vlerë**	**Aktivet në mbulim të provigjoneve bruto**
Paraja në arkë dhe bankë (më pak se 3muaj)	3%	23,682	23,682
Të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera (maturitet më të vogël se 3 muaj)	20%	91,163	23,080
Letra me vlerë të tregëtuara në tregje të parregulluara	10%	78,940	9,702
Depozita me afat (pa përfshirë fondin e garancisë)	no limit	-	488,918
Investime në letra me vlerë (pa përfshirë fondin e garancisë)	no limit	-	382,710
Aktive të risigurimit (klasifikuar mbi BBB-)	no limit	-	7,724
Tokat dhe ndërtesa	30%	236,820	12,833
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara përjashtuar tokat dhe ndërtesat	5%	39,470	2,468
Interes i llogaritur dhe shpenzime të parapaguara	5%	39,470	39,470
Totali			**990,587**
Niveli i mbulimit			**125%**